



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1099/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj, duke vendosur përkitazi me ankesën e Kushtrim Cukaj nga Komuna e Pejës, paraqitur kundër Komisionereve të qendrave të vendvotimeve, për shkak të parregullsive në manipulim e votave gjatë procesit zgjedhor, në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Kushtrim Cukaj nga komuna e Pejës.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 03.12.2013, nga Kushtrim Cukaj nga komuna e Pejës i cili thekson se në qendrat e votimit 1703c shkollën fillore “Lidhja e Prizrenit” në Pejë, si dhe në vendvotimin 1703/01R votat e familjës dhe e imja personale për kandidatën e PDK-së Afërdita Lajçi të cilës nuk i figurojnë të numëruara dhe nuk ka asnjë votë. Në Këtë rast mendoj se është bërë shkelje dhe manipulim i votës së lirë, dhe kërkoj që të numërohet vota ime.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

PZAP-i konstatoi se nga dëshmit e ofruara si provë të cilat gjenden në shkresat e lëndës nuk ka prova të mjaftueshme që do t'i bënim të besueshëm pretendimet ankimore të ankuesit Kushtrim Cukaj nga komuna e Pejës. PZAP-i, i vlerëson si të pabazura dhe të pa argumentuara në prova dhe dëshmi bindëse siç pretendon pala ankuese andaj ankesa e tillë është e pa bazuar dhe për këtë çështje PZAP-i në mbështetje të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, si dhe neni 3.6 pika c) të Rregullorës së PZAP-i lidhur me ankesën e lartpërmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 1099/2013 më datën 06.12.2013



**Kryesuesi i Panelit
Ferit Osmani**

Këshillë Juridik:

Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës mbrenda 24 (njëzetekatër) orë nga moment i marrjes së vendimit nga PZAP-i.